



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 278/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11.06.2021 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Univers Servis” SHPK, në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavijonet e Spitalit Universitar Obstetrik- Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me nr. REF-68613-08-13-2020, me fond limit 185,496,117 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK
Adresa: Godinë 1 katëshe, pranë tregut rural të fruta perimeve, Xhafzotaj, Durrës.
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqendruara
Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 3, Tiranë.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të ankimuesit.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 14.08.2020 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavijonet e Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik “Koço Gliozheni”*”, me nr. REF-68613-08-13-2020, me fond limit 185,496,117 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datën 11.12.2020 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Devis” SHPK	113,165,591.30 lekë, skualifikuar;
2. “Univers Servis” SHPK	171,224,352.00 lekë, skualifikuar;
3. “Balkan Laundry” SHPK	178,112,688.00 lekë, skualifikuar;
4. “AGS” shpk & “Euro Alb” SHPK	181,793,142.06 lekë, skualifikuar;
5. “Ë. Center” SHPK	pa ofertë ekonomike, skualifikuar;

II.3. Në datën 11.12.2020, operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK është njoftuar elektronikisht për skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi, me arsyetimin si më poshtë:

“• Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjermën dh), pika 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk arriti të provojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik. Referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë, rezulton se operatori ka 2 vende të ushtrimit të aktivitetit, ndërkohë që nga Vërtetimi i OSHEE –së, së paraqitur në SPE, ka të deklaruar vetëm 1 kontratë të energjisë elektrike, pra për një vend të ushtrimit të aktivitetit”

II.4. Në datën 17.12.2020, operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar pranë KPP nga autoriteti kontraktor, ky i fundit më anë të shkresën nr.2482/2 prot, datë 22.12.2020, i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik “Univers Servis” SHPK, duke e refuzuar atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

[...]Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi verifikoi dokumentet e tenderit, vlerësimin e bërë në sistemin e prokurimit elektronik dhe procesverbalin e mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, dokumentet e dorëzuara nga ofertuesi “UNIVERS SERVIS” SHPK, pretendimet e parashtruara në ankesë mbi skualifikimin e ofertës së tij, konstatoi se:

Në dokumentet e tenderit, në Shtojcën nr.8. pika 2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, pika 1, gjërma “dh”, përcaktohet se: “I. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: ... dh. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.”.

Nga ana tjetër, në VKM-në nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 4, gjërma ”ç”, është parashikuar shprehimisht se: ”4. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: ... ç) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.”.

Për ofertuesin “UNIVERS SERVIS” SHPK, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka njoftuar he dhënë automatikisht nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik më datë 11.12.2020, arsyet e skualifikimit, si vijon: “Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjermën dh), pika 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk arriti të provojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik. Referuar Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë, rezulton se operatori ka 2 vende të ushtrimit të aktivitetit, ndërkohë që nga Vërtetimi i OSHEE —së, së paraqitur në SPE, ka të deklaruar vetëm 1 kontratë të energjisë elektrike, pra për një vend të ushtrimit të aktivitetit.”.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, verifikoi në sistemin e prokurimit elektronik dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës ekonomike nga ofertuesi “UNIVERS SERVIS” SHPK dhe konstatoi se, ky ofertues ka paraqitur në SPE, dokumentin me emërtim “Vërtetim

FSHU”, në të cilin ndodhet shkresa me nr.1545/1prot. datë 11.09.2020 “Vërtetim debie për operatorët ekonomikë për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik,...” e lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, Durrës, sipas të cilit bazuar në deklaratimet e deklaruesit, përfaqësuesit ligjor të UNIVERS SERVIS SHPK, nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit për kontratën me kod: DU2C0700250754001 titullar/përdorues i së cilës është UNIVERS SERVIS SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.09.2020, duke përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2020. Edhe në dokumentin bashkëngjitur ankesës së ofertuesit “UNIVERS SERVIS” SHPK, shkresa me nr.2791/1prot. datë 15.12.2020 “Kthim përgjigje” e lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA, Durrës, ofertuesi është bërë me dije se nga verifikimet e kryera në sistemin e faturimit, për subjektin me emër “UNIVERS SERVIS” SHPK, me nipt L01703501S, rezulton të ketë vetëm një kontratë me FSHU SHA kontratën me kod: DU2C0700250754001.

Për sa më sipër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave sqaron se, qëllimi i parashikimit të këtij kriteri, si në VKM-në 914/2014, i ndryshuar, ashtu edhe në dokumentet e tenderit të procedurave të prokurimit, si detyrim për t'u përmbushur nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, është që të provohet se nga ana e këtyre abonentëve jofamiljar, zbatohen parashikimet e akteve ligjore e nënligjore në fuqi, që nga lidhja e kontratave të energjisë me furnizuesin e deri te shlyerja e të gjitha detyrimeve të maturuara për konsumin e energjisë elektrike. Në rastin konkret, ofertuesi ka arritur të provojë se ka shlyer detyrimet vetëm për njërin nga vendet e ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar, ndërkohë që referuar të dhënave të ekstraktit të regjistrimit tregtar, rezulton se ofertuesi ushtron aktivitet në dy vendndodhje, për të cilat ofertuesi ka barrën e provës për paraqitjen e dokumentacionit provues të shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në cilësinë e përdoruesit (qiramarrës, huapërdorës, etj) ose titullarit (pronar).

Për arsyet e më sipërme, pretendimi i ofertuesit “UNIVERS SERVIS” SHPK, nuk pranohet. [...]

II.6. Në datën 29.12.2020, operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK, ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke argumentuar, si më poshtë vijon:

[...]Në cilësinë e ofertuesit në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga Agjencia e Blerjeve të Përqendruara, me objekt “Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavijonet e Spitalit Universitar Obstetrik - Gjinekologjik “Koço Gliozheni””, më datë 11.12.2020, nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit jemi njohur me vendimin e AK për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga jonë në procedurën e sipërcituar. Lidhur me arsyen e skualifikimit (për mosplotësim të kriterit të përcaktuar në gërmën dh), pika 1, të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit), ku KVO pretendon se nuk është arritur të provohet se ofertuesi ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik, nëpërmjet ankesës së paraqitur pranë AK, kemi sqaruar dhe sqarojmë si vijon:

Referuar dokumenteve të tenderit, në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 1, shkronja “dh” është kërkuar që ofertuesit të paraqesin një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK me NUIS L01703501S, rezulton të ketë patur dhe ka vetëm një kontratë me OSHEE/FSHU, konfirmuar kjo nga vërtetimi nr. 1545/1, datë 11.09.2020.

Të dhënat e abonentëve administrohen nga sistemi dhe janë të aksesueshme nga çdo operator i FSHU, kështu që në çdo rast, nëse do të evidentoheshin detyrime të pashlyera të operatorit ekonomik që ka aplikuar për tu pajisur me një vërtetim për çdo lloj kontrate që ai ka me OSHEE/FSHU, në vërtetimin e lëshuar do të reflektoheshin të gjitha kontratat dhe respektivisht dhe raporti i operatorit ekonomik kundrejt detyrime kontraktore dhe për rrjedhojë

Për të mbështetur argumentin si më sipër bashkëlidhur ankesës vumë në dispozicion shkresën nr. 2791/1, datë 15.12.2020 të FSHU sh.a., ku konfirmohet se shoqëria “Univers Servis” SHPK, me NUIS L01703501S, ka vetëm një kontratë me FSHU. Në përfundim theksojmë se me dokumentacionin e paraqitur në momentin e zhvillimit të procedurës, operatori ekonomik e ka plotësuar kërkesën për kualifikim, pasi për të vetmen kontratë që ka (atë me kod DU2C070025075401) ka paraqitur vërtetimin se nuk ka detyrime të maturuara të pashlyera ndaj OSHEE/FSHU. Për sa më sipër, kërkuam rivlerësimin e ofertës së paraqitur nga shoqëria “Univers Servis” SHPK, duke e kualifikuar atë, pasi me dokumentacionin e paraqitur vërteton se i plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Në përgjigje të ankesës së bërë dhe argumenteve të paraqitura AK, me shkresën nr. 2482/2, datë 22/12/2020, na informon se ankesa është refuzuar me argumentin si vijon:

Në rastin konkret ofertuesi ka arritur të provojë se ka shlyer detyrimet vetëm për njërin nga vendet ushtrimit të aktivitetit të tij tregtar, ndërkohë që referuar të dhënave të ekstraktit të RT, rezulton se ofertuesi ushtron aktivitet në dy vendndodhje, për të cilat ka barrën e provës për paraqitjen e dokumentacionit provues të shlyerjes së detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në cilësinë e përdoruesit (qiramarrës, huapërdorës, etj ose titullarit (pronar).

Një vendimmarrje e tillë, bie ndesh me qëllimin e LPP të shprehur në nenin 1, pika 2, me parimet e shprehura në nenin 2 si dhe me përcaktimet e nenit 53 të LPP, pasi nuk sigurohet një trajtim i barabartë midis ofertuesve dhe AK nuk ka marrë asnjë nismë për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ofertave. Me keqardhje konstatojmë se Autoriteti Kontraktor (si KVO ashtu edhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës):

- Së pari nuk ka marrë mundimin të kërkojë asnjë sqarim nga ofertuesi, pavarësisht të drejtës që i jep ligji dhe së dyti bën një interpretim tendencioz të kërkesës për kualifikim të përcaktuar në Kriteret e Veçanta për Kualifikim, pika 1, shkronja “dh”, ku është kërkuar që ofertuesit të paraqesin një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Pavarësisht se ofertuesi e ushtron aktivitetin tregtar në dy vende, me dokumentacionin e paraqitur vërtetohet se për të vetmen kontratë që ofertuesi ka me OSHEE, nuk ka detyrime të maturuara për energjinë elektrike dhe nqs ky operator do të kishte detyrime për këtë apo për çdo kontratë tjetër, ato padyshim që do të pasqyroheshin në vërtetimin e lëshuar nga OSHEE. Kërkesa për kualifikim referon te kontratat e energjisë elektrike që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri dhe jo detyrimisht çdo vend ushtrim aktiviteti shoqërohet me kontratë të energjisë elektrike. Pavarësisht sa më sipër, sqarojmë se jemi të hapur dhe mirëpresim çdo verifikim të mundshëm që KPP gjykon të nevojshëm, pasi të dhënat e administruara nga OSHEE mundësojnë/lejojnë verifikimin në çdo kohë të abonentëve debitorë dhe momentin kur shlyen detyrimet për kontratat që ata kanë [...]

II.8. Njëpërmjet shkresës nr. 12/1 prot., datë 05.01.2021, protokolluar me tonën në datën 07.01.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes.

II.9. Njëpërmjet shkresave nr. 1817/5 prot., datë 17.02.2021 dhe nr. 1817/6 prot. datë 17.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga OSHEE Group SHA.

II.9.1. Njëpërmjet shkresave nr. 1718/1 prot., datë 02.06.2021 dhe nr. 1719/2 prot. datë 02.06.2021, protokolluar me tonën në datën 04.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i kërkuar nga OSHEE Group SHA.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Univers Servis” SHPK për skualifikimin e ofertës së tij me arsyen: *“Ofertuesi nuk plotëson kriterin e përcaktuar në gjermën dh), pika 1 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, pasi nuk arriti të provojë se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik. Referuar Ekstraktit të Regjistrit Tregtar të Shoqërisë, rezulton se operatori ka 2 vende të ushtrimit të aktivitetit, ndërkohë që nga Vërtetimi i OSHEE –së, së paraqitur në SPE, ka të deklaruar vetëm 1 kontratë të energjisë elektrike, pra për një vend të ushtrimit të aktivitetit”* Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8, pika 2.1.dh, “Kapaciteti teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri si më poshtë vijon:

“dh. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim debie nr. 1545/1 prot., datë 11.09.2020, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit...z. P.Gj, vërtetohet se kërkuesi “UNIVERS SERVIS” SHPK nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën (me kod) DU2C070025075401, titullar / përdorues i së cilës është “UNIVERS SERVIS” SHPK, rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 11.09.2020, duke përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2020.[...]

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa neni 53, pika 3 përcakton: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”*

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: “Për të provuar përmbushjen e kriterit për kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik”.*

III.1.5. Në nenin 9 (*“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”*), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin nr.109, datë 21.10.2011 të ERE *“Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: “Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.”*

III.1.6. Me anë të shkresës nr. 1817/5 prot., datë 17.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga OSHEE Group SHA, si më poshtë vijon:

“[...]Në kuadër të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit të sipërcituar, për Komisionin e Prokurimit Publik është tepër i nevojshëm informacioni juaj si më poshtë:

1. Kontratat e energjisë elektrike në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK

2. Në cilën adresë jepet shërbimi i energjisë elektrike nëpërmjet kontratës me kod DU2C070025075401.

3. A rezulton të jetë subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresën “Lagjja Nr. 8, Rr. “Aleksandër Goga”, Spitali Rajonal Durrës ?

4. Nëse është përdorues në adresën e mësipërme, a ka patur detyrimin që subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK ta deklarojë këtë fakt pranë furnizuesit me energji elektrike “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”? [...]”

III.1.7. Nëpërmjet shkresës nr. 1719/2 prot. datë 02.06.2021, protokolluar me tonën në datën 04.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i kërkuar nga OSHEE Group SHA, me anë të së cilës Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SHA, informon si më poshtë vijon:

“[...]1)Subjekti tregtar “Univers Servis” sh.p.k, referuar të dhënave sistemit të faturimit nuk rezulton të jetë titullar ose përdorues në kontratë furnizimi me energji elektrike, me Furnizuesin e Shërbimit Universal sh.a. pjesë e Grupit OSHEE .

- 2) *Kontrata e energjisë elektrike me kod klienti DU2C070025075401, me titullar kontrate “Lavanderi Univers”, sipas detajeve bashkëngjitur rezulton në adresën Xhafzotaj Shijak.*
- 3) *Subjekti tregtar “Univers Servis” sh.p.k, referuar të dhënave sistemit të faturimit, nuk rezulton titullar përdorues i asnjë kontrate të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal sh.a. pjesë e Grupit OSHEE, rrjedhimisht as në adresën e cituar në shkresën tuaj.*
- 4) *Për rrjedhojë që subjekti tregtar “Univers Servis” sh.p.k, nuk është titullar apo përdorues i asnjë kontrate energjie elektrike, nuk ka asnjë detyrim monetar kundrejt Furnizuesit të Shërbimit Universal sh.a. pjesë e Grupit OSHEE.*

Sipas të dhënave në Sistemin e Faturimit, që përfaqëson bazën e të dhënave të shoqërisë sonë, rezulton se konsumatorët janë të regjistruar vetëm me emër, mbiemër dhe jo me atësi. Në bazë të kushteve rregullatore të mëparshme, konsumatorët nuk ishin të detyruar të paraqisnin të dhëna të detajuara personale apo një kopje të dokumentit zyrtar të identifikimit.

Me ndryshimet e fundit të kushteve rregullatore, të miratuara nga Enti Rregullator i Energjisë, konsumatorëve të rinj (të cilët procedojnë me hapjen e kontratave të reja), u kërkohet që të deklarojnë të dhëna personale më të detajuara dhe paraqitjen e dokumenteve identifikuese.

Sikurse sqaruam edhe më sipër, lutemi që këto të dhëna të merren në konsideratë me rezervë sepse për shkak të mungesës së pasqyrimit të të dhënave më të detajuara, nuk sigurojmë saktësinë e plotë të tyre[...]

III.1.8. Me anë të shkresës nr. 1817/6 prot., datë 17.02.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka kërkuar informacion nga OSHEE Group SHA, si më poshtë vijon:

“[...]Gjatë shqyrtimit të ankesave të paraqitura ndër vite, por edhe aktualisht, Komisioni i Prokurimit Publik ka patur dhe ka si objekt shqyrtimi pretendime lidhur me përmbushjen e kriterit të kualifikimit, i cili lidhet me vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Kriter ky, i detyrueshëm në zbatim të neneve: 26 pika 7/c; 27 pika 5/c; 28 pika 4/ç të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në kuadër të shqyrtimit administrativ sa më rigoroz dhe në përputhje me parimet dhe përcaktimet e përcaktuara në legjislacionin për prokurimin publik në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon nga ana juaj që të na informoni lidhur me mënyrën e verifikimit dhe hartimit të vërtetimeve të lëshuara nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, që konfirmojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në rastet kur subjekti tregtar është titullar i kontratës së energjisë, si dhe në rastet kur subjekti tregtar është përdorues i kontratave të energjisë dhe ushtron aktivitetin tregtar duke përdorur energjinë elektrike nëpërmjet një kontrate në të cilën nuk është titullar i saj [...]

III.1.9. Nëpërmjet shkresës nr. 1718/1 prot. datë 02.06.2021, protokolluar me tonën në datën 04.06.2021, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i kërkuar nga OSHEE Group SHA, me anë të së cilës Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SHA, informon si më poshtë vijon:

“[...]Verifikimi i kontratave që ka në zotërim apo përdorim një operator ekonomik bëhet:

1. Duke kërkuar në sistemin tonë të faturimit për kontrata të cilat rezultojnë në emër apo me Nipt të operatorit ekonomik.

2. Bazuar në kërkesën e abonentit dhe mbi deklarinimin e kodeve të kontratave që mund të ketë në përdorim në ambiente me qira.

3. Pasi verifikohen kodet e kontratave bëhet verifikimi nëse kanë detyrime të prapambetura dhe procedohet me lëshimin e vërtetimit të debisë.

Operatori ekonomik mund të aplikojë për vërtetim debie në të gjitha qendrat tona të kujdesit ndaj klientit, zyrat qendrore dhe nëpërmjet aplikacionit E-albania [...]”

III.1.10. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, përkatësisht ekstraktit të regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit “Univers Servis” SHPK, rezultoi se ky i fundit kryen aktivitet tregtar në dy adresat si vijon: “Godinë 1, katëshe, ngjitur me tregun rural i fruta-perimeve, Xhafzotaj, Durrës”; “Lagjja Nr. 8, Rr. “Aleksandër Goga”, Spitali Rajonal Durrës”. Në kuadër të shqyrtimit administrativ sa më rigoroz dhe në përputhje me parimet dhe përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik ju drejtua nëpërmjet shkresave nr. 1817/5 prot., datë 17.02.2021 dhe nr. 1817/6 prot. datë 17.02.2021, OSHEE Group SHA, duke i kërkuar informacion lidhur me mënyrën e verifikimit dhe hartimit të vërtetimeve të lëshuara nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, që konfirmojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, në rastet kur subjekti tregtar është titullar i kontratës së energjisë, si dhe në rastet kur subjekti tregtar është përdorues i kontratave të energjisë dhe ushtron aktivitetin tregtar duke përdorur energjinë elektrike nëpërmjet një kontrate në të cilën nuk është titullar i saj. Gjithashtu, u kërkuar informacion i posaçëm lidhur me kontratat e energjisë elektrike në të cilat është titullar ose përdorues subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK, në cilën adresë jepet shërbimi i energjisë elektrike nëpërmjet kontratës me kod DU2C070025075401, nëse rezulton të jetë subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK titullar apo përdorues i një apo më shumë kontratave të energjisë elektrike në adresën “Lagjja Nr. 8, Rr. “Aleksandër Goga”, Spitali Rajonal Durrës, si dhe nëse ka patur detyrimin që subjekti tregtar “Univers Servis” SHPK të deklarojë se është përdorues në adresën e mësipërme, pranë furnizuesit me energji elektrike “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”. Lidhur me kërkesat e mësipërme, ka kthyer përgjigje Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) SHA, duke informuar se lëshimi i vërtetimit të debisë bëhet pasi është kryer verifikimi i kodeve të kontratave që vetëdeklarohen nga abonenti (në rastet kur ky i fundit ka kontratë në përdorim në ambiente me qira), si dhe kontratave që rezultojnë në sistemin e FSHU SHA në emër dhe me Nipt të operatorit ekonomik. Ndërsa lidhur me operatorin ekonomik “Univers Servis” SHPK, FSHU SHA informon se ky subjekt nuk rezulton të jetë as titullar dhe as përdorues i asnjë kontrate të furnizimit me energji elektrike me Furnizuesin e Shërbimit Universal SHA, e rrjedhimisht as në adresën “Lagjja Nr. 8, Rr. “Aleksandër Goga”, Spitali Rajonal Durrës”. Gjithashtu, FSHU SHA informon se titullar i kontratës DU2C070025075401 është subjekti “Lavanderi Univers”.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike një vërtetim të lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal SHA sipas formatit të miratuar, me anë të së cilës vërtetohet se subjekti “Univers Servis” SHPK nuk rezulton debitor, deri në datën 11.09.2020, duke përfshirë faturën koherente të muajit Gusht 2020, për kontratën me kod DU2C070025075401, përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 15.09.2020 dhe Vendimit të ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”. Referuar fakteve dhe rrethanave të mësipërme, Komisioni vëren se vërtetimi i mësipërm është lëshuar në kushtet e vetëdeklarimit të

operatorit ekonomik ankimues si përdorues i kontratës me kod DU2C070025075401, pasi operatori ekonomik ankimues nuk rezulton të këtë në cilësinë e titullarit apo përdoruesit asnjë kontratë të regjistruar në sistemin e FSHU SHA. Duke u kthyer te arsyeja e skualifikimit, përpara se të konkludohet në një qëndrim përfundimtar mbi përmbushjen apo jo të kriterit të kualifikimit nga operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK, Komisioni gjykon të ndalet dhe të analizojë ndarjen ndërmjet detyrimeve të një operatori ekonomik për përmbushjen e një kriteri kualifikimi të kërkuar nga autoriteti kontraktor dhe mënyrës së përmbushjes së këtij kriteri nga operatori ekonomik. Në lidhje me detyrimin për përmbushjen e një kriteri kualifikimi, neni 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” e përcakton qartë se operatorët ekonomik kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme dhe nëse nuk plotësohet qoftë një kriteri i vetëm, autoriteti kontraktor është i detyruar që të refuzojë ofertën. Ndërsa në lidhje me mënyrat e përmbushjes së kriterëve për kualifikim, Komisioni thekson se përcaktohen ose nga vetë autoriteti kontraktor, i cili vendos dokumentacionin që duhet paraqitur në SPE në dokumentet e tenderit, gjithmonë brenda diskrecionit të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkretë, arsyeja e skualifikimit lidhet me përmbushjen një kriteri i cili është i sanksionuar në nenin 27, pika 5, gërma “c”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet edhe dokumenti konkretë me anë të të cilit përmbushet ky kriter. Në këtë dispozitë, përcaktohet se të gjithë operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet që me anë të një vërtetimi të konfirmojnë shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri dhe mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Gjithashtu, në po këtë dispozitë është përcaktuar se subjekti që lëshon këtë vërtetim është furnizuesi me energji elektrike.

III.1.12. Referuar nenit 27, pika 5, gërma “c”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ndarja ndërmjet plotësimit apo mosplotësimit të këtij kriteri është paraqitja ose jo e vërtetimit të lëshuar nga Furnizuesi me energji elektrike, si dhe shlyerja ose jo e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike për kontratat që operatori ekonomik është titullar apo përdorues. Në rastin konkretë, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur një vërtetim që konfirmon se në kontratën e vetëdeklaruar me kod DU2C070025075401 nuk rezulton debitor përfshirë edhe muajin e fundit të maturuar referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit datë 15.09.2020. Nga ana tjetër, me anë të shkresës nr. 1719/2 prot. datë 02.06.2021, FSHU SHA, i cili është edhe subjekti përgjegjës për lëshimin e vërtetimit përkatës në bazë të nenit 27, pika 5, gërma “c”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ka informuar Komisionin e Prokurimit Publik se subjekti “Univers Servis” SHPK nuk rezulton debitor, pasi nuk ekziston si konsumator i energjisë elektrike qoftë si titullar kontrate, apo si përdorues i saj. Në këto kushte, për sa kohë që vetë subjekti që verifikon dhe ka tagrin që të vërtetojë ekzistencën e detyrimeve dhe debive që palët kanë ndaj tij, nuk e konsideron si debitor operatorin ekonomik ankimues, si dhe për sa kohë është paraqitur një vërtetim me përmbajtje në përputhje me kërkesat e autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, atëherë Komisioni gjykon se operatori ekonomik

“Univers Servis” SHPK e ka për mbushur kriterin e kualifikimit. Akoma më tej, Komisioni gjykon se fakti që një operator ekonomik deklaroi disa adresa alternative të ushtrimit të aktivitetit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, nuk mund të paragjykohet se domosdoshmërisht është titullar, përdorues apo konsumator i energjisë elektrike dhe për më tepër debitor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Univers Servis” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Shërbimi i lavanderisë dhe hotelerisë në pavijonet e Spitalit Universitar Obstetrik- Gjinekologjik “Koço Gliozheni”, me nr. REF-68613-08-13-2020, me fond limit 185,496,117 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 15.09.2020, nga autoriteti kontraktor Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Të anulojë vendimin e autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Univers Servis” SHPK dhe të korrigojë shkeljet duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Univers Servis” SHPK
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1817 Protokoli Datë 29.12.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri